



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-065

Prishtinë, më 13 maj 2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 MAJ 2019

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Muharrem Nitaj, Dardan Sejdiu, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci, Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Kërkesa e 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
5. Kërkesat për mbështetje financiare.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i shtyu për miratim procesverbalet e mbledhjeve të mëparshme për mbledhjen e radhës.

2. Kërkesa e 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 40 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38, pika 2c të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 14 maj 2019, në orën 10:00, me rend dite: - Gjendja në Telekomin e Kosovës me masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës në zbatim të Rezolutës 1206/L-013, datë 12. 7. 2018 në lidhje me gjendjen financiare në Telekom dhe në Postën e Kosovës.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar për seancë të jashtëzakonshme, deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, i propozoi Kryesisë së Kuvendit që në seancën e jashtëzakonshme t'i lejohet fjala kryetarit të Federatës Sindikale të Telekomit, z. Lamih Balaj. Diskutimi i plotë i deputetes Albulena Haxhiu është i dhënë në transkript.

Lidhur me propozimin e lartshënuar të deputetes Albulena Haxhiu, diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; deputeti Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së; Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së dhe Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetes Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, për lejimin e fjalimit në seancën e jashtëzakonshme të kryetarit të Federatës Sindikale të Telekomit, z. Lamih Balaj.

Me dy (2) vota “për” (nënkryetarët: Kujtim Shala dhe Aida Dërguti) dhe dy (2) vota “kundër” (kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe nënkryetarja Mufera Srbica-Shinik), Kryesia e Kuvendit nuk e miratoi propozimin e lartshënuar.

Pastaj, Kryesia vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme të martën, më 14 maj 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me gjendjen në Telekomin e Kosovës dhe masat që i ka ndërmarre Qeveria e Kosovës në zbatimin e Rezolutës nr. 06-R-013, datë 12. 7. 2018 lidhur me gjendjen financiare në Telekom dhe në Postën e Kosovës.

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, me propozim të kryetarit të Kuvendit, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 16 maj 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Shqyrtimi i Propozim-Rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë,*
- 4. Formimi i Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë,*
- 5. Vendimi për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, tek ish - Fabrika e tjegullave,*
- 6. Vendim për ndërtimin e Memorialit të dëbimit, tek Stacioni hekurudhor i Prishtinës,*
- 7. Çaktimi i Ditës së Gjenocidit.*

* * *

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit se Kuvendi do ta mbajë edhe një seancë të veçantë, më 21 maj 2019, në orën 11:00, për përkujtimin e 20-vjetorit të Masakrës së Dubravës.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që në këtë seancë të ftohen të mbijetuarit e Masakrës së Dubravës.

* * *

Nënkryetarja e Kuvendit, znj Aida Dërguti, propozoi që Propozim-amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit të radhitet si pikë e parë e seancës së radhës. Diskutim i saj plotë është dhënë në transkript.

Kryesia, në lidhje me propozimin e lartshënuar, vendosi që Shqyrtimi i propozim-amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të radhitet si pikë e parë e rendit të ditës në vazhdimin e seancës plenare, të caktuar për të mëkuarën, më 15 maj 2019.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma Legjislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Nisma Legjislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, me vet iniciativë e kishte shqyrtuar këtë projektligj dhe e kishte proceduar për shqyrtim në parim për seancë plenare.

Kryesia vendosi që shqyrtimi në parim i këtij Projektligji, të radhitet në rend dite për seancën e re plenare të radhës.

Kryesia po ashtu lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256 u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022

Kryesia, pasi e shqyrtoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022.
2. Ministria e Financave të njëjtën ta përfshijë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2020-2022.

Gjithashtu, në lidhje me Projektin “Qendra Administrative Protokollare në Gërmi”, u konstatua që i njëjti të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Ndërsa, për krijimin e hapësirave të reja për punën për deputetët, kryetari tha se pas largimit të Zyrës së Presidentit nga objekti i Kuvendit do të krijohen kushte më të përshtatshme për punë.

5. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

6. Kërkesa e deputetit Armend Zemaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë të GP të LDK-së, për debat parlamentar në lidhje me mosrespektimin e të drejtave të punëtorëve përfshirë orarin e stërzgatur të punës, punësimin pa kontrata pune, pagesa jo të rregullta, si dhe mosrespektimi i kushteve të tjera të parapara me Ligj për punëtorët që punojnë në sektorin e shërbimeve, qendrave tregtare, sektorin e ndërtimtarisë, hotelerisë dhe tregtisë

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite për seancën e re plenare të radhës.

7. Kërkesa e deputetit Imet Rrahmani, mbështetur edhe nga 5 deputetë të GP të LDK-së, për debat parlamentar në lidhje me aksidentet në komunikacion që po përfundojnë me vdekje, lëndimeve të rënda trupore dhe dëmeve materiale, mosrespektimin e ligjeve të miratuara që e rregullojnë fushën e qarkullimit në komunikacion, gjendjen teknike të automjeteve dhe trajnimin e shoferëve të rinj

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite për seancën e re plenare të radhës.

8. Kërkesa e deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë nga GP i PSD-së, për debat parlamentar në lidhje me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve hetues në Republikën e Kosovës

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite për seancën e re plenare të radhës.

9. Kërkesa për lejimin e shpenzimeve për përkujtimin e 20-vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës, më 22 maj 2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbulimin e shpenzimeve për shënimin e 20-vjetorit të masakrës së Burgut të Dubravës, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 06/3159/Do-1667, datë 18.04.2019, që do të mbahet më 22 maj 2019.

10. Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të Komisionit për Edukim dhe Mjete të Informimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, prej 13 - 14 maj 2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet vizita dy (2) ditore e delegacionit të Komisionit për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit të Shqipërisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej 13 - 14 maj 2019, si dhe mbulohen të gjitha shpenzimet e parapara sipas programit të vizitës.

11. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Fitore Pacolli-Dalipi, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica dhe Zafir Berisha u lejohet udhëtimi zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar, prej 21 - 25 maj 2019.

12. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Elmi Reçica dhe Armend Zemaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej 6 - 9 qershor 2019.

13. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Preshevë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ismajl Kurteshi, Nait Hasani, Teuta Haxhiu, Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Arban Abrashi dhe Valon Ramadani u lejohet udhëtimi zyrtar në Preshevë, prej 5 - 6 qershor 2019.

14. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bregun e Fildishtë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Flora Brovina, Sami Kurteshi dhe Haxhi Shala u lejohet udhëtimi zyrtar në Bregun e Fildishtë, prej 3 - 10 korrik 2019.

15. Kërkesa e deputetit Veton Berisha për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Veton Berisha, i lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani, prej 17 - 20 maj 2019.

16. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Evgjeni Thaçi-Dragusha për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Evgjeni Thaçi-Dragusha, i lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani, prej 19 - 22 maj 2019.

17. Kërkesa e deputetit Etem Arifi për mbulimin e shpenzimeve të biletave në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Etem Arifi për mbulimin e shpenzimeve të biletave të udhëtimit në shumën prej 365,00 euro, lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani, prej 14 - 18 mars 2019.

18. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit nga SHBA-të për Lutjet e Mëngjesit, i cili do të qëndrojë në Kosovë, prej 12 - 19 maj 2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve të akomodimit për delegacionin pesë (5) anëtarësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe shpenzimet e tjera të dala me rastin e pritjes së këtij delegacioni lidhur me vizitën zyrtare në Kosovë për pjesëmarrje në Lutjet e Mëngjesit, prej 12 - 19 maj 2019, sipas kërkesës së bashkangjitur, me nr. 06/3229/DO-1721, datë 10. 5. 2019.

19. Kërkesa për mbulimin e tejkallimit për akomodim në lidhje me vizitën zyrtare të realizuar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Vjosa Osmani-Sadriu, Doruntinë Maloku-Kastrati, Safete Hadërgjonaj, Xhevahire Izmaqu dhe Fisnik Ismaili u lejohet tejkallimi i shpenzimeve lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej 7 - 13 prill 2019, në shumën sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 06/3206/DO-1701, datë 6. 5. 2019.

20. Kërkesa për mbulimin e tejkallimit për akomodim në lidhje me vizitën zyrtare të realizuar në Kanada

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Flora Brovina, i lejohet mbulimi i tejkallimit të shpenzimeve lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Otavë (Kanada), prej 24 - 28 prill 2019, në shumën sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 06/3217/Do-1712, datë 7. 5. 2019.

21. Kërkesa e deputetes Mimoza Kusari-Lila për mbulimin e shpenzimeve për një darkë zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, për mbulimin e shpenzimeve në shumën prej 412,60 euro për drekën zyrtare të shtruar më 27 mars 2019, me rastin e vizitës zyrtare në Kosovë të dy (2) deputetëve të Parlamentit Kanadez, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 06/1314/Do-1633, datë 10. 4. 2019.

22. Kërkesa e deputetit Slobodan Petroviq lidhur me rekomandimin e Policisë së Kosovës për sigurinë e tij

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetit Slobodan Petroviq lidhur me rekomandimin e Policisë së Kosovës për sigurinë e tij.

Gjithashtu, kryetari i njoftoi të pranishmit për vendimin e marrë nga kryetari i Kuvendit që z. Petroviq i lejohet sigurimi dhe vendosja e pajisjeve në vendbanimin e tij sipas rekomandimit të Policës së Kosovës, nr. 01/0207-2019.

23. Njoftimi për themelimin e Grupit Joformal të Deputetëve të Gjellbër

Kryesia, pasi u njoftua për themelimin e Grupit Joformal të Deputetëve të Gjellbër dhe me kërkesën e deputetes Mimoza Lila-Kusari, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Administrata e Kuvendit t'ia mundësojë Grupit Joformal të Deputetëve të Gjellbër që ta promovojnë aktivitetin e tyre në ueb-faqen e Kuvendit, si dhe t'i ofrojë mbështetje teknike dhe profesionale.

24. Njoftimet e disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës lidhur me vizitat zyrtare të realizuara në Mal të Zi, Republikën Çeke, Slloveni, Belgjikë dhe Turqi

Kryesia u njoftua me shkrim nga disa deputetë, lidhur me vizitat zyrtare të realizuara, si në vijim:

1. Deputetët: Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Fisnik Ismaili e kanë realizuar udhëtimin zyrtar në Podgoricë (Mal të Zi), më 8 mars 2019.
2. Deputetja Xhevahire Izmaku e ka realizuar e udhëtimin zyrtar në Pragë të Republikës Çeke, prej 27 - 30 mars 2019.
3. Deputeti Slobodan Petroviq ka marrë pjesë në Seminarin e NATO-s, i cili është mbajtur në Turqi, prej 11 - 15 prill 2019.
4. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka realizuar udhëtimin zyrtar në Slloveni, prej 10 - 14 mars 2019.
5. Komisioni për Zhvillim Ekonomik e ka realizuar udhëtimin zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 18 - 20 shkurt 2019.

* * *

5. Kërkesat për mbështetje financiare

Kryesia në lidhje me kërkesat për mbështetje financiare, i autorizoi nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Kujtim Shala, që t'i shqyrtojnë ato dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara me Rregulloren nr. 05-R-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere t'i rekomandojnë Kryesisë së Kuvendit për vendimmarrje.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale